



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:013943
Datë: 11.12.2024
Numri i dokumentit: 06583100

ARJ.nr.123/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani, kryetar, Zenel Leku dhe Beshir Islami anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit I.K., nga P., të cilin me autorizim e përfaqëson avokat Rifat Kelmendi, kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMShCK), në P., përfaqësuar nga A.P. Sh., dhe Qeveria e Republikës së Kosovës-Zyra e Kryeministrit, Agjencia e Statistikave të Kosovës, me bazë juridike anulimin e aktit administrative-vendimit A.nr.309/2020 të datës 03.12.2020, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të paditësit, ushtruar nga i autorizuari i tij, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.622/2023 të datës 13.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10 Dhjetor 2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e paditësit I.K., nga P., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.622/2023 të datës 13.06.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr.622/2023 të datës 13.06.2024, është vendosur si në vijim: **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësit I.K., e datës 22.08.2023, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.190/2021 të datës 27.07.2023, **VËRTETOHET**.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, shkeljes të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të: I. APROVOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e paditësit, II. ANULOHEN Aktgjykimi i Gjykatës së

Apelit, AA.nr.622/2023 të datës 13.06.2024 dhe ai i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.190/2021 të datës 27.07.2023 dhe çështja të i kthehet në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë. Ose I. APROVOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e paditësit, II. NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, AA.nr.622/2023 të datës 13.06.2024 dhe ai i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.190/2021 të datës 27.07.2023, III. ANULOHET si i kundërligjshëm vendimi - akti administrativ i të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, me A.nr.309/2020 me nr.prot 2915/2020 i datës 03.12.2020 dhe vendimi përmes emailit të Ministres së MFPT, për mos Ri zgjatje të Kontratës, dhe paditësi Isa Krasniqi kthehet në vendin e tij të punës, Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, respektivisht Drejtor i Përgjithshëm, emërim i njëjtë sipas konkursit të MPB-së. IV. DETYROHET e paditura e dytë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), respektivisht sipas Vendimit Nr.05/84, të datës 22.06.2022 të Qeverisë së Kosovës, tash Zyra e Kryeministrit, që sipas nenit 42, paragrafi 2 dhe 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ta kthejë në vendin e tij të punës si shërbyes civil në pozitën lartë drejtuese Kryeshef Ekzekutiv (Drejtor i Përgjithshëm sipas Konkursit të MPB-së) i Agjencisë së Statistikave të Kosovës me të gjitha të drejtat që rrjedhin nga marrëdhënia e punës që nga data e shkëputjes së marrëdhënies së punës datë 13.10.2020 e deri në ekzekutimin e këtij Aktgjykimi. V.DETYROHET e paditura e tretë Agjencia e Statistikave të Kosovës, qe paditësit t'ia paguaj shumën totale prej 17,595.44 Euro, (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë euro e dyzet e katër cent) me kamatë ligjore prej 8% në emër të pagave - diferencën neto dhe beneficinet e tjera lidhur me pozitën e lartë drejtuese, për periudhën nga data 13.01.2021 e deri më 31.03.2023 në afat prej 8 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë. VI. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës, në shumën e përgjithshme prej 1,965 Euro, (një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë euro) në afat prej 8 ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit nuk ka ushtruar pala e paditur.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se i padituri Këshilli i Pavarur mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), me vendimin A.nr.309/2020 të datës 03.12.2020, ka vendosur si në vijim: REFUZOHET si e pabazuar ankesa A.nr.309/2020 e datës 20.10.2020, e parashtruar nga ankuesi Isa Krasniqi. II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetarja e kolegjit.

Në arsyetim të vendimit kontestues ndër të tjera theksohet se: Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke ju referuar provave të lëndës ka konstatuar që ankuesi në pozitën

Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës është emëruar dhe ju ka vazhduar mandati tre (3) vjeçar dy herë radhazi në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të nenit 22 të Rregullores Nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, respektivisht mandati si Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, i ka skaduar më datë 13.10.2020 sepse pozitat e nivelit të lartë drejtues kanë qenë me mandat tre (3) vjeçar ashtu siç është përcaktuar me nenin 15 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës: *“Komisioni zhvillon procedurën e konkurrimit dhe në fund të saj i propozon ministrisë përgjegjëse për administratë publike tre (3) kandidaturat më të mira. Ministria përgjegjëse për administratë publike iu dërgon titullarit të institucionit për miratim(3) kandidaturat më të mira, për institucionet e ekzekutivit, Ministria përgjegjëse për administratë publike i propozon Qeverisë për miratimin kandidatin e preferuar nga titullari i institucionit, i cili miratohet nga Qeveria në pozicionin përkatës për një mandat tre (3) vjeçar..”*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi Isa Krasniqi pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës e ka ushtruar për tri (3) mandate radhazi (nga data 28.09.2011 deri më datë 13.10.2020), çka nënkupton se mandati i tretë ankuesit i ka përfunduar më datë 13.10.2020, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/1-114 për Zyrtarët Publikë, andaj si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në nenin 83 paragrafin 8 ndërlidhur me neni 42 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, i cili thekson se për një nëpunës civil të kategorisë së lartë drejtuese, i emëruar sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L149), i cili është duke shërbyer në mandatin e ti/saj të parë, do të aplikohet neni 42. ndërsa neni 42 paragrafi 4 parasheh se *“Emërimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese, sipas paragrafit 1 të këtij neni, bëhet për një kohëzgjatje 4-vjeçare me të drejtë një rizgjatje, për të njëjtën pozitë pune, vetëm një herë dhe për të njëjtën kohëzgjatje”* dhe në rastin konkret për ankuesin Isa Krasniqi nuk ka qenë mandati i tij i parë në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, andaj kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave vlerëson se në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik mund t’i vazhdohet mandati, nëpunësve civil të kategorisë së lartë drejtuese të emëruar sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të cilët e kanë ushtruar vetëm një mandat, ndërsa nuk mund ti vazhdohet mandati nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese të emëruar sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të cilët kanë ushtruar më tepër se një mandat në të njëjtën pozitë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka konstatuar së në bazë nenit 83 paragrafit 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, përcaktohet se *“Një nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese në një institucion të administratës shtetërore, i emëruar në këtë pozitë sipas procedurës së Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, do të vazhdojë mandatin e tij/saj për kohën e mbetur të përcaktuar në Ligjin e Shërbimit Civil nr.03/L-149 të Republikës së Kosovës”*, andaj në rastin konkret pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, ankuesi pasi ka qenë i emëruar në pozitën e Kryeshefit ekzekutiv me mandat trevjeçar sipas procedurës së Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i njëjti e ka vazhduar mandatin e tij për kohën e mbetur respektivisht për më shumë se tre muaj, deri me njoftimin e datës 12.10.2020, me të cilin Ministria e Ministrisë së Financave

në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik e njofton ankuesin se udhëheqësi i radhës i Agjencisë së Statistikave do të emërohet sipas procedurave të rekrutimit me çka nënkupton se ankuesit i ka përfunduar mandati i tij.

Kundër aktit të lartë cekur të KPMSHCK paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin A.nr.190/2021 të datës 27.07.2023, ka vendosur si në vijim: Refuzohet kërkesëpapia e paditësit I. K.,-P., kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës-Zyra e Kryeministrit, Agjencia e Statistikave të Kosovës, me të cilën ka kërkuar të anulohet vendimi A.nr.309/2020 datë 03.12.2020 dhe vendimi i Ministres së MFPT për mos ri zgjatje të kontratës, të detyrohet e paditura e dytë Qeveria e Republikës së Kosovës-Zyra e kryeministrit që paditësin ta kthej në vendin e punës si shërbyes civil në pozitën e lartë drejtuese kryeshef ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës-Drejtor i përgjithshëm me të gjitha të drejtat që rrjedhin nga marrëdhënia e punës që nga data e shkëputjes së punës datë 13.10.2020, e deri në ekzekutimin e këtij aktgjykimi, të detyrohet e paditura e tretë Agjencia e Statistikave të Kosovës që paditësit ti paguaj shumën totale prej 17,595.44 (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë euro e dyzet e katër cent), me kamatë ligjore prej 8 %, në emër të pagave-diferencave neto dhe beneficioneve të tjera lidhur me pozitën e lartë drejtuese për periudhën 13.01.201-31.03.2023, në afat prej 8 ditësh nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit në kërcënimin e ekzekutimit me dhunë, të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 1,965 (një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë) euro në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë, si e pa bazuar. Në pikën II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Në arsyetim të aktgjykimit të saj ndër të tjera thekson se: Gjykata e shkallës së parë vërtetoi gjetjet e të paditurit në vendimin e kontestuar dhe konstatoi se e paditura me të drejtë ka aplikuar nenin 42 par 4 dhe 83 par 8 të Ligjit për Zyrtarët Publik. Gjykata kishte parasysh nenin 15 të Ligjit për Shërbimin Civil (bazuar në periudhën e mandateve të këtu paditësit 28.09.2011-13.10.2020) ku përcaktohet: *“1. Sekretarët e përgjithshëm dhe pozicionet e barasvlershme me ta zgjidhen nga një listë e nëpunësve civilë të klasifikuar në pozitat e larta drejtuese dhe pozitat drejtuese sipas rregullave për klasifikimin e pozitave të përcaktuara nga ky ligj, ose në pozita të tjera të barasvlershme në institucionet e administratës publike ose kompanitë publike dhe private, të cilët janë kandidatë për pozitën përkatëse, e cila përpilohet në bazë të aplikacioneve të pranuar pas shpalljes së një konkursi publik. 3. Komisioni zhvillon procedurën e konkurrimit dhe në fund të saj i propozon ministrisë përgjegjëse për administratë publike tre (3) kandidaturat më të mira. Ministria përgjegjëse për administratë publike ia dërgon titullarit të institucionit për miratim (3) kandidaturat më të mira. Për institucionet e ekzekutivit, Ministria përgjegjëse për administratë publike i propozon Qeverisë për miratim kandidatin e preferuar nga titullari i institucionit, i cili miratohet nga Qeveria në pozicionin përkatës për një mandat tre (3) vjeçar. Për institucionet jashtë ekzekutivit, titullari i institucionit përzgjedh një (1) nga tre (3) kandidatët e propozuar nga Komisioni”*.

Tutje theksohet se, duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. ref.:AGJ 1583/20, datë 9 korrik 2020 si dhe shfuqizimit të vendimit për masat e përkohshme, Gjykata kishte

parasysh Ligjin për Zyrtarët Publik neni 42 ku përcaktohet: “4. Emërimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese, sipas paragrafit 1 të këtij neni, bëhet për një kohëzgjatje 4-vjeçare me të drejtë një ri zgjatje, për të njëjtën pozitë pune, vetëm një herë dhe për të njëjtën kohëzgjatje”, kurse me nenin 83 të po këtij Ligji përcaktohet:” 8. Për një nëpunës civil të kategorisë së lartë drejtuese, i emëruar sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L149), i cili është duke shërbyer në mandatin e tij/saj të parë, do të aplikohet neni 42, paragrafi 2 i këtij ligji”. Duke pasur parasysh vendimet e datës 28.09.2011 me të cilin këtu paditësi emërohet kryeshef ekzekutiv në Entin e Statistikave me mandat 3 vjeçar, vendimin 01.10.2014 me të cilin i vazhdohet mandati si kryeshef ekzekutiv në Agjencinë e Statistikave edhe për tre vite, me vendimin e datës 13.10.2017, po për këtë pozitë i vazhdohet mandati edhe për tri vite, andaj bazuar në datën e përfundimit të mandatit të këtu paditësit 13.10.2020, i njëjti ishte duke ushtruar këtë pozitë edhe gjatë periudhës së zbatimit të Ligjit për Zyrtarët Publik dhe duke pasur parasysh se me nenin 42 të Ligjit për Zyrtarët Publik përcaktohet emërimi në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese për kohëzgjatje 4 vjeçare me të drejtë një rizgjedhje dhe duke pasur të ditur se këtu paditësi ka ushtruar këtë pozitë për tre mandate radhazi në këtë raste edhe dispozita e nenit 83 par. 8 të Ligjit për Zyrtarët Publik pamundëson rizgjedhjen-vazhdimin e mandatit për këtu paditësin për faktin se kjo dispozitë përcakton aplikimin e nenit 42 par 2 në raste kur mandati i shërbyesit është i parë e që në rastin e paditësit i njëjti kishte mandatin e tretë, andaj mbi këtë bazë e paditura drejtë ka konstatuar se këtu paditësit nuk mund ti vazhdohet mandati i nëpunësit civil për kategori të lartë drejtuese të emëruar sipas Ligjit për Shërbimin Civil, e që ka ushtruar më tepër se një mandat në rastin e paditësit tre mandate.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që i njëjti të anulohet dhe çështjen t’ia kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së dhe 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjyimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshtetimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadsisë së paditësit. Andaj kjo gjykatë vlerëson se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i ligjshëm dhe në kuptim të dispozitave nga neni 49 të LKA-së, nenit 200 të LPK-së, lidhur me nenin 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjyimit të saj.

Në arsyetim të aktgjyimit të Gjykatës së Apelit, ndër të tjera theksohet se: gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të paditurës si në vështrim të nenit 9, dhe 44 të LKA, në seancën e shqyrtimit kryesor, si në vështrim të nenit 38.1.2 të LKA, pas administrimit të provave, dhe në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, vendos drejtë me lënien në fuqi të vendimit të organit të paditur, si vendim i drejtë dhe ligjor i nxjerrë në bazë të dispozitave ligjore të LPPA, dhe ligjit material, ku pa dyshim është vërtetuar se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme. Kolegji i apelit e pranon si të drejtë

konstatimin e gjykatës së shkallës së parë se duke u bazuar në vendimet e datës 28.09.2011 me të cilin paditësi emërohet kryeshef ekzekutiv në Entin e Statistikave me mandat 3 vjeçar, vendimin 01.10.2014 me të cilin i vazhdohet mandati si kryeshef ekzekutiv në Agjencinë e Statistikave edhe për tre vite, me vendimin e datës 13.10.2017, po për këtë pozitë i vazhdohet mandati edhe për tri vite, andaj bazuar në datën e përfundimit të mandatit të këtu paditësit 13.10.2020, i njëjti ishte duke ushtruar këtë pozitë edhe gjatë periudhës së zbatimit të Ligjit për Zyrtarët Publik dhe duke pasur parasysh se me nenin 42 të Ligjit për Zyrtarët Publik përcaktohet emërimi në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese për kohëzgjatje 4 vjeçare me të drejtë një rizgjedhje dhe duke pasur të ditur se këtu paditësi ka ushtruar këtë pozitë për tre mandate radhazi në këtë raste edhe dispozita e nenit 83 par 8 të Ligjit për Zyrtarët Publik pamundëson rizgjedhjen-vazhdimin e mandatit për këtu paditësin për faktin se kjo dispozitë përcakton aplikimin e nenit 42 par. 2 në raste kur mandati i shërbyesit është i parë e që në rastin e paditësit i njëjti kishte mandatin e tretë.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të kontestuar, shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vepruar kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit por edhe të Gjykatës Themelore, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkëlqje të dispozitave të procedurës të LKA apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala paditëse në kërkesë. Sipas gjendjes faktike të vërtetuar të çështjes në shqyrtim nga organi i paditur dhe gjykatat e instancave më të ulëta rezulton se drejtë është aplikuar e drejta materiale. Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga rezulton se drejtë është vendosur me refuzimin si të pabazuar të kërkesëpadsisë së paditësit dhe ankesës na gjykata e shkallës së dytë duke e aplikuar drejtë Ligjin për Zyrtar Publik, përkatësisht nenet 42, par. 4 dhe neni 83 par. 8, të cituara si në aktgjykimet e instancave më të ulëta dhe organi i paditur KPMSHC si në vendimin e tij nga ligjrisht rezulton se, për deri sa paditësi kishte ushtruar pozitën e lartë në shërbimin civil, Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave-Drejtor i Përgjithshëm për tre mandate nga viti 28.09.2011, (mandati i fundit, i tretë, i kishte përfunduar e dt. 13.10.2020), sipas dispozitës së nenit 84 par. 8 të Ligjit për Zyrtar Publik, pamundësohet rizgjedhja për faktin se sipas kësaj dispozite përcaktohet se, në rastet kur për të emëruarin civil të kategorisë së lartë drejtuese është mandati i parë i emëruar sipas Ligjit për Shërbimin Civil 03/L-149, do të aplikohet neni 42, par. 2, i Ligjit për Zyrtar Publik e që në rastin e paditësit nuk ishte mandati i parë, andaj bazuar në këtë gjendje faktike të çështjes, i padituri KPMSHC dhe gjykatat e instancave më të ulëta me të drejtë kanë vendosur si në vendimet e tyre në baza ligjore, sepse paditësi i kishte përfunduar tri mandate në këtë kategori të lartë drejtuese si nëpunës civil i emëruar sipas Ligjit për Shërbimin Civil.

Gjykata shqyrtoj pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, por vlerësoj se të njëjtat janë shqyrtuar nga gjykatat e instancave më të ulëta, të njëjtat janë të pabazuara dhe jo me ndikim për

vendosjen ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur gjykatat e instancave më të ulëta. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë. Aktgjykimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Përveç kësaj, edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Gjykata nuk shqyrtoi pretendimet e tjera të parashtruesit të kërkesës, lidhur me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pasur parasysh se, sipas dispozitës së nenit 24 paragraf 2 të LKA-së, përcaktohet se: *“Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes”*.

Nga theksimet si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konflikte Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.123/2024, më datë 10 Dhjetor 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani